

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretarën juridike [REDACTED], duke vendosur në çështjen kontestimore juridiko-civile të paditësit [REDACTED] nga [REDACTED], kundër të paditurit [REDACTED] nga [REDACTED], për çështjen kontestuese pagimi i borxhit, në seancen kryesore te mbajtur me dt.22.05.2017 në pranin e paditësit dhe të autorizuarit dhe në mungesën e të paditurit, bëri përpilimin me shkrim të këtij:

#### A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET, në tërsi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga [REDACTED] dhe DETYROHET, i padituri [REDACTED] nga [REDACTED] rruga “[REDACTED]” nr.[REDACTED] që paditësit të i'a paguaj shumë prej 1.410.00 €, në emër të borxhit dhe huasë këtë shumë me kamat prej 8% duke filluar prej dt.22.05.2017, e deri ne pagesën definitive.

II. DETYROHET, i padituri që paditësit të t'ia paguaj shumën në pikën I si dhe shpenzimet e procedures kontestimore,në shumë prej 539€, e cila pagesë do të bëhet ne afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit në dorzim të këtij aktgjykimi.

#### A r s y e t i m

Paditësi perms të autorizuarës së saj si në padi ashtu në seancat e mbajtura gjyqësore i kanë propozuar gjykatës qe kërkesëpadinë e paditësit ta miratoj në tërsi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurin që paditësit t'ia paguajnë shumën prej 1.410 €, në emër të borxhit dhe qerasë.

Ka theksuar se me të paditurin e ka lidhur kontratën mbi qeranë dhe i'a ka dhënë në shfrytëzim lokalini afarist i cili gjendet në rrugën “Lagjja e Re” nr.100 në sip. prej 150m<sup>2</sup>,ndërsa pala e paditur ka marrë detyrim që ta paguajë qeranë mujore në shumë prej 150€ e kjo e precizuar në nenin 4 të kontratës mbi qeranë.Poashtu në të njejtën date paditësi i huazon të paditurit edhe mjete financiare në shumë prej 1200€,këto mjete i'a huazon për blerjen e inventarit të lokalit.E të cilën shumë i padituri merr për detyrim që të i'a paguaj brenda muajit gusht të vitit 2015, këto mjete i padituri nuk i'a kthen por i'a kthen vetëm shumën prej 390€, ndërsa mbetet borxh në shumë prej 810€.Poashtu i padituri ka mbetur borgj edhe shumën prej 600€ për 4 muaj në emër të qerasë.

Se i padituri paditësit i ka mbetur borxh edhe për qeranë e pa paguar për lokalin këtë fakt Gjykata e vërtetoi nga kontrata mbi qeranë e përpiluar më dt.12.08.2015, e nënshkruarnga palët ndergjyqëse por e pa vërtetuar , ndërsa se ka mbetur borxh edhe shumën prej 810€ për mjetet të cilat i ka huazuar këtë fakt Gjykata e vërtetoi nga deklaratat e dëshmiotarëve [REDACTED] dhe [REDACTED] të cilët në seancën gjyqësore të dt.22.05.2017 e kanë vërtetuar se i padituri paditësit i ka mbetur borgj në shumë prej 1410€, nga këto baza i kanë propozuar gjyaktës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi sit e pa bazuar.

Shpenzimet i kanë kërkuar.

Gjykata shqyrtimin kryesor e ka mbajtur në mungesën e të paditurit, sepse i padituri ka qenë i ftuar me rrgull, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe nuk ka kërkuar shtyerjen e shqyrtimit gjyqësor, andj janë plotësuar kushtet nga neni 423.4 të LPK-së.

Gjykata të paditurit më dt. 20.01.2017, i,a ka dërguar padinë me prova si dhe 25.01.2017, dhe në afatin e paraparë ligjorë nuk ka ushtruar përgjegje në padi.

Për të vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe gjykuar në mënyr të drejtë ne këtë çështje kontestimor të kompenzimit të dëmit, gjykata bëri administrimin e këtyre provave të shkruara duke bërë leximin: u lexua kontrata e qerasë, dhe deklaratat e dëshmitarëve [REDACTED] dhe [REDACTED] pa pyetje dhe pa vërejtje.

Pas vlersimit me kujdes dhe profesionalizëm të secilës prove veq e veq dhe të gjithave bashkarisht, e në bazë të dispozitave të nenit 8 të LPK-së,si dhe bindjes së lir të gjykatë,kjo gjykatë për këtë qështj kontestimore vërtetoj këtë gjendje këtë gjendje faktike:

Paditësit të paditurit i'a ka dhënë me qera lokalini afarist i cili gjendet në rrugën "Lagja e Re" nr.1,lokalin i'a ka dhënë në shfrytëzim me qera në shumë prej 150€.Përveç lokalit i'a ka huazuar edhe shumën prej 1200€.I padituri paditësit i'a ka kthyer shumën prej 390€, ndërsa i ka mbetur borxh 4 muaj për qera dhe 810€ në emër të borxhit.

a) Se paditësi të paditurit i'a ka dhënë në shfrytësim lokalini afarist këtë fakt Gjykata e vërtetoi nga kontrata e qerasë e dt.12.08.2015,ku [REDACTED] nga Kaçaniku tani paditës i'a jep në shfrytëzim [REDACTED] nga [REDACTED] tani i paditur lokalini i cili gjendet në [REDACTED] në rrugën "[REDACTED]" nr.1 me sip. prej 100m2.Poashtu këtë fakt Gjykata e ka vërtetuar edhe nga deklaratat e dëshmitarëve [REDACTED] dhe [REDACTED] ë të dy nga [REDACTED] të cilët në seancën e dt. 22.05.2017 kanë deklaruar se i padituri e ka marrë në shfrytëzim lokalini e lartëshënuar.

b) se i padituri e ka marrë lokali e shënuar më lartë me qera mujore në shumë prej 150€ këtë fakt Gjykata e ka vërtetuar nga kontrata e qerasë edhe atë në nenin 4 ku është shënuar se qeraja mujore caktohet në shumë prej 150€ dhe e cila duhet të paguhet deri më dt.05 të çdo muaji .

c) se paditësi të paditurit i ka huazuar edhe mjete, këtë fakt Gjykata e ka vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarëve [REDACTED] dhe [REDACTED],të cilët kanë deklaruar se paditësi të paditurit i'a ka dhënë këto mjete e këtë fakt e dijnë sepse kanë qenë prezent kur paditësi këto mjete i'a ka dhënë të paditurit tek restaurant ‘[REDACTED]’ në [REDACTED]

d) se i padituri ka mbetur borxh në shumë prej 1410€ edhe atë shumën prej 600 në emër të qerasë për 4 muaj dhe shumën prej 810€ për mjetet e huazuara, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarëve të cilët kanë deklaruar se i padituri i'a ka borxh paditësit këtë shumë sepse kanë marrë pjesë gjatë bisedave të cilat janë bërë në mes të palëve ndergjygjëse për kthimin dhe barazimin e borxhit.

Gjykata pas analizimit të provave kërkësëpadinë e paditësit e ka mitratuar në tërësi si të bazuar dhe e ka detyruar të paditurin që paditësit të i'a paguaj shumën e borxhit prej 1.410 €, edhe atë shumën prej 810€ në emër të mjeteve të huazuara dhe shumën prej 600€ në emër të qerasë për 4 muaj, e këto fakte gjykata i vërtetoi edhe nga deklaratat e dëshmitarëve edhe nga kontrata mbi qeranë , e duke i pasur për bazë këto fakte gjyakta vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike e cila u vërtetua në mënyr të plot dhe të drejt që rezultoi nga të gjitha provat e nxjerrura dhe të vlersuars, gjykat vlerëson se janë eliminuar të gjitha faktet kontestuese për vendim marrje dhe kërkësëpadinë e paditësit e miratoi pjesërisht si të bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, duke zbatuar edhe dispozitën e nenit 323të LPK-së.

Gjykata nxjerri aktgjykim për shak të mungesës, sepse janë plotësuar kushtet nga neni 151 i LPK-së, sepse i padituri është thirr rregullisht për në seancë, nuk e ka kontestuar kërkësë padinë me anë të parashtresës, nga themelsia e kërkësë padisë del nga gaket e treguara në padi, faktet në të cilat bazohet kërkësë padia nuk janë në kundërshtim me provat e paraqitura nga paditësi, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata i analizoi theksimet e palës paditëse e cila i propozoj gjykatës që padinë dhe kërkësëpadin e paditësit ta miratoj në tërësi si të bazuar e të cilat theksime gjykata u'a dha besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykim, sepse nga kontrata mbi qeranë e ka vërtetuar se i padituri e ka pasur në shfrytëzim lokalini afarist si dhe nuk e ka paguar qeranë, e këtë fakt e ka vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarëve .Ndërsa sa i përket mjeteve në shumë prej 810€ që ka mbetur borxh në emër të huasë këtë fakt gjykata e vërtetoi nga deklaratat e dëshmitarëve .

Gjykata e detyroi të paditurin që paditësit të ja paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 539 €, edhe atë shumën prej 104€ përpilimin e padisë dhe shumën prej 405€ për 3 seanca dhe shumën prej 30€ në emër të taksës për padi (të parapara sipas udhëzimit administrativ nr.1/2017 të Këshillit Gjyqësorë), gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.I të LPK-së

Nga të gjitha arsyet e paraqitura dhe rezultatet e përgjithëshme të procedurës kontestimore, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

C.nr.35/16 prej dt.22.05.2017

Gjyqtari

Riza Livoreka



UDHËZIME JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë të paraqes ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.



VENDIMI ESHTË I PLOTFUQISHEM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA  
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA NE KAÇANIK  
OSNOVNI SUD UROSEVAC OGRANAK U KAÇANIK

Më 04.05. 2017  
Dana